



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 135

Tiranë – E premte, 15 shtator 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 534, datë 13.9.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës ‘Theofan Popa’, Bashkia Elbasan”..... 15629
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 535, datë 13.9.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura Himarë dhe largimi i ujërave të trajtuara në det për ITUN Himarë”..... 15633
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 536, datë 13.9.2023	Për lirimimin dhe emërimin në detyrë të prefektit të Qarkut të Kukësit 15635
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 537, datë 13.9.2023	Për një shtesë në numrin e punonjësve organikë në administratën e Kuvendit për vitin 2023..... 15635
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 13.9.2023	Për miratimin e marrëveshjes së zbatimit për projekte të bashkëpunimit teknik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dhe <i>Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH</i> 15635
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 539, datë 13.9.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 456, datë 22.5.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen dhe mënyrën e funksionimit të Komitetit Kombëtar të Shëndetit Mendor”..... 15646
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 324/6, datë 12.9.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i shesheve të pallateve në lagjen ‘Partizani’, ZK 8524, Bashkia Elbasan”..... 15648

**VENDIM****Nr. 534, datë 13.9.2023**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT
“RIKONSTRUKSION DHE ASFALTIM I
RRUGËS ‘THEOFAN POPA’, BASHKIA
ELBASAN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës ‘Theofan Popa’, Bashkia Elbasan”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Elbasan.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 11 975 209.6 (njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e dyqind e nëntë pikë gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 11 975 209.6 (njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e dyqind e nëntë pikë gjashtë) lekësh, përballohet nga Bashkia Elbasan.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Elbasan.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Elbasan.

8. Bashkia Elbasan kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Elbasan.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Elbasan për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Elbasan për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Elbasan, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

NR.	PRONARI			TË DHËNAT KADAISTRALË (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)										TË DHËNAT PËR SHPRONËSIM				SHËNIME
	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Truall (m²)	Ndërtesë (m²)	Volumi	Faqe	TRUALL					
													Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	VLERA TOTALE (lek)		
1	Flutur	Hajdar	Belegu	Elbasan	8525	6/159	Truall	889	889	0	1	25	2.5	14,192	35,480.00	35,480.00	Mbi këtë pasuri ndodhet ndërtesa me nr. pas. 6/159-nd. 1 dhe 6/159-nd. 2. Ka një ndërtim të paligjshëm. Konfirmuar nga ASHK-ja.	
	Elida	Esat	Sorra															
	Marlena	Xhaferri	Belegu															
	Elisabeta	Esat	Sorra															
	Behije	Hajdar	Belegu															
	Erjeta	Hajdar	Belegu															
	Fatmira	Hajdar	Belegu															
	Suzana	Esat	Sorra															
	Bexhet	Musa	Belegu															
	Luan	Xhaferri	Belegu															
2	Edmond	Esat	Sorra	Elbasan	8525	6\81	Truall	353	353	0	1	28	17	14,192	241,264.00	241,264.00	Ka një ndërtim të paligjshëm. Konfirmuar nga ASHK-ja.	
	Ermine	Musa	Belegu															
	Erjeta	Hajdar	Belegu															
	Behije	Hajdar	Belegu															
	Marlena	Xhaferri	Belegu															
	Edmond	Esat	Sorra															
	Fatmira	Hajdar	Belegu															
	Luan	Xhaferri	Belegu															
	Suzana	Esat	Sorra															
	Ermine	Musa	Belegu															
3	Bexhet	Musa	Belegu	Elbasan	8525	6\82	Truall	532	532	0	1	29	27,3	14,192	387,441.60	387,441.60	Ka dy ndërtime të paligjshme. Konfirmuar nga ASHK-ja.	
	Flutur	Hajdar	Belegu															
	Elida	Esat	Sorra															
	Elisabeta	Esat	Sorra															
	Fatmira	Hajdar	Belegu															
	Erjeta	Hajdar	Belegu															
	Luan	Xhaferri	Belegu															
	Flutur	Hajdar	Belegu															
	Suzana	Esat	Sorra															
	Edmond	Esat	Sorra															
4	Behije	Hajdar	Belegu	Elbasan	8525	6/155	Truall	282	282	0	1	17	8.8	14,192	124,889.60	124,889.60	Ka një ndërtim të paligjshëm. Konfirmuar nga ASHK-ja.	
	Marlena	Xhaferri	Belegu															
	Ermine	Musa	Belegu															
	Erjeta	Hajdar	Belegu															
	Flutur	Hajdar	Belegu															
	Fatmira	Hajdar	Belegu															
	Behije	Hajdar	Belegu															
	Marlena	Xhaferri	Belegu															
	Xhaferri	Belegu																
	Edmond	Esat	Sorra															
5	Suzana	Esat	Sorra	Elbasan	8525	6/146	Truall	457	457	0	1	18	0.7	14,192	9,934.40	9,934.40	Ka dy ndërtime të paligjshëm. Konfirmuar nga ASHK-ja.	
	Elida	Esat	Sorra															
	Elisabeta	Esat	Sorra															
	Flutur	Hajdar	Belegu															
	Fatmira	Hajdar	Belegu															
	Behije	Hajdar	Belegu															
	Marlena	Xhaferri	Belegu															
	Luan	Xhaferri	Belegu															
	Ermine	Musa	Belegu															
	Bexhet	Musa	Belegu															



6	Erjeta	Hajdar	Belegu	Elbasan	8525	6/433	Truall	2617	2617	0	22	143	30.2	14,192	428,598.40	428,598.40	Ka një ndërtim të paligjshëm. Konfirmuar nga ASHK-ja.
	Sonja	Kleanth	Santo (Deda)														
	Arben	Gavril	Santo														
	Manola	Santo	Santo (Shakaj)														
	Klea	Petra	Santo														
	Vasil	Jorgji	Santo														
	Mira	Gavril	Santo (Durrës)														
	Marhen	Petra	Santo														
	Eduart	Kole	Papamihali														
	Merita	Kole	Bajraktari														
	Jorgji	Santo	Santo														
	Veronika	Santo	Santo (Kita)														
7	Eduart	Kole	Papamihali	Elbasan	8525	7\95	Truall	792.5	792.5	0	2	179	88	14,192	1,248,896.00	1,248,896.00	Diferenca e sip. truall dok-fakt = 88 m². Konfirmuar nga ASHK-ja.
	Klea	Petra	Santo														
	Arben	Gavril	Santo														
	Mira	Gavril	Santo (Durrës)														
	Vasil	Jorgji	Santo														
	Merita	Kole	Bajraktari														
	Marhen	Petra	Santo														
	Manola	Santo	Santo (Shakaj)														
	Veronika	Santo	Santo														
	Sonja	Kleanth	Santo(Deda)														
	Jorgji	Santo	Santo														
	Aferdita	Mahmut	Gjevari														
8	Dafina	Ndini	Gjevari	Elbasan	8525	6/479	Truall	2947.57	2947.57	0	37	66	131	14,192	1,859,152.00	1,859,152.00	Mbi këtë truall ndodhet ndërtesa me nr. pas. 6/438-nd. Ka dy ndërtime të paligjshme. Konfirmuar nga ASHK-ja.
	Agim	Qazim	Gjevari														
	Qazim	Hasan	Gjevari														
	Ilirjana	Hasan	Gjevari														
9	Ruzhdi	Mustafa	Fagu	Elbasan	8525	6/446	Truall	2227	2227	0	28	197	173	14,192	2,455,216.00	2,455,216.00	Kjo pasuri ka 5 ndërtime pa leje. Konfirmuar nga ASHK-ja.
10	Veri	Mersin	Koci	Elbasan	8525	6/443	Truall	366	366	0	26	68	18	14,192	255,456.00	255,456.00	Me datë 1.6.2020 u bë RVP në vlerën 519668464 lekë e vlefshme deri në kryerjen e një transaksioni. Kjo pasuri ka një ndërtim pjesërisht të paligjshëm. Konfirmuar nga ASHK-ja.
11	Selami	Mersin	Koci	Elbasan	8525	6/442	Truall	251	251	0	26	67	29	14,192	411,568.00	411,568.00	Kjo pasuri ka një ndërtim pjesërisht të paligjshëm. Konfirmuar nga ASHK-ja.
12	Sabaudin	Mustafa	Fagu	Elbasan	8525	6/460	Truall	2108.43	2108.43	0	35	34	122.7	14,192	1,741,358.40	1,741,358.40	Ka dy ndërtime të paligjshme. Konfirmuar nga ASHK-ja.
	Fiorentina	Dilaver	Shkodra														
	Irimi	Dilaver	Shkodra														
	Ali	Dilaver	Fagu														
13	Ilir	Vasil	Leka	Elbasan	8525	6/220	Truall + ndërtesë	276,5	276,5	127.1	24	84	17.7	14,192	251,198.40	251,198.40	Kjo pasuri ka një ndërtim të paligjshëm. Konfirmuar nga ASHK-ja.
	Luljeta	Kostandin	Leka														
14	Jorgo	Dritan	Demin	Elbasan	8525	7\99	Truall	143	143	0	2	144	4	14,192	56,768.00	56,768.00	U bë RVP në vlerën 2022360 lekë e vlefshme deri në kryerjen e një transaksioni. Konfirmuar nga ASHK-ja.
	Shpetime	Agron	Demiri														
15	Zeqine	Kamber	Shengjergji	Elbasan	8525	7\97	Truall	249	249	0	2	142	10	14,192	141,920.00	141,920.00	Mbi këtë pasuri ka një ndërtim të paligjshëm. Konfirmuar nga ASHK-ja.
	Xhemali	Daut	Shengjergji														
16	Artan	Themi	Mehilka	Elbasan	8525	7\98	Truall	470	470	0	2	143	9.4	14,192	133,404.80	133,404.80	Mbi këtë pasuri ka një ndërtim të paligjshëm. Kjo pasuri ka një ndërtim pjesërisht të paligjshëm. Konfirmuar nga ASHK-ja.
17	Velson	Shefki	Pisha	Elbasan	8525	6/450	Truall	343	343	0	29	233	7	14,192	99,344.00	99,344.00	Mbi këtë truall ndodhen ndërtesat me nr. pas. 6/450 -nd. 1, pas. nr. 450-nd. 2 dhe pas. nr. 6/450-nd. 3. Konfirmuar nga ASHK-ja.
	Rakip	Shefki	Pisha														
18	Hafize	Agim	Purde	Elbasan	8525	6/306	Truall + ndërtesë	402	402	89,2	1	27	13,8	14,192	195,849.60	195,849.60	Konfirmuar nga ASHK-ja.
	Enkl	Evedin	Purde														
	Brunilda	Evedin	Purde														
19	Naim	Shefqet	Pisha	Elbasan	8525	7/129	Truall + ndërtesë	299	299	127	24	97	41	14,192	581,872.00	581,872.00	Kjo pas vihet në hipotekë në favor të Bankës Kombëtare Tregtare me



																	kontratë hipotekare nr. 697/436 date 28.05.2014 për shumën 3 000 000 lekë. Konfirmuar nga ASHK-ja.
20	Bardhyl	Daut	Vaska	Elbasan	8525	6/153	Truall	836	836	0	1	15	4.3	14,192	61,025.60	61,025.60	Me datë 23.2.2017 u bë rrvlerësimi i pasurisë në vlerën 18031292 lekë e vlefshme deri në kryerjen e një transaksioni. Vendoset kufizim me shkresën nr. 1971 prot., datë 21.2.2017 të ALUJZNI-t, pasi qytetari është debitor pranë OSHEE-së. Konfirmuar nga ASHK-ja.
21	Behar	Qamil	Muzhaçi	Elbasan	8525	7/131	Truall + ndërtesë	259	259	86	24	99	5.6	14,192	79,475.20	79,475.20	Konfirmuar nga ASHK-ja.
22	Qamil	Qazim	Bakiu	Elbasan	8525	6/156	Truall + ndërtesë	723	723	171	1	13	11.4	14,192	161,788.80	161,788.80	Konfirmuar nga ASHK-ja.
23	Ismail	Mehmet	Suli	Elbasan	8525	7/194	Truall + ndërtesë	259	259	94	28	111	6.2	14,192	87,990.40	87,990.40	Konfirmuar nga ASHK-ja.
24	Haki	Xhevit	Asllani	Elbasan	8525	7/205	Truall	1067	1067	0	31	11	21	14,192	298,032.00	298,032.00	Mbi këtë truall ndodhet ndërtesa me nr. pas. 7/60-nd. Ka një ndërtim të paligjshëm. Konfirmuar nga ASHK-ja.
25	Manushaqe	Daut	Gorani	Elbasan	8525	6/481	Truall	424	424	0	37	83	22	14,192	312,224.00	312,224.00	Ka një ndërtim të paligjshëm. Konfirmuar nga ASHK-ja.
26	Riza	Feta	Gorani	Elbasan	8525	6/482	Truall	100	100	0	37	84	14	14,192	198,688.00	198,688.00	Me dok me ref. 017231 u bë rrvlerësimi i pasurisë në vlerën 1419200 lekë, e vlefshme deri në kryerjen e një transaksioni. Konfirmuar nga ASHK-ja.
	Luljeta	Ibrahim	Gorani														
27	Arben	Qemal	Çela	Elbasan	8525	7/199	Truall + ndërtesë	147	147	89.6	29	182	8.2	14,192	116,374.40	116,374.40	Mbi këtë truall ndodhet ndërtesa me nr. pas. 7/199. Konfirmuar nga ASHK-ja.
Fadil	Qemal	Çela															
Vlera totale e shpronësimit																11,975,209.60	

**VENDIM****Nr. 535, datë 13.9.2023**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË
SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKET NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “IMPIANTI I TRAJTIMIT
TË UJËRAVE TË NDOTURA HIMARË
DHE LARGIMI I UJËRAVE TË
TRAJTUARA NË DET PËR ITUN
HIMARË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura Himarë dhe largimi i ujërave të trajtuara në det për ITUN Himarë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Himarë.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit “godinë”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi, prej 783 000 (shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 783 000 (shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë) lekësh, përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Himarë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

8. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarit të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Himarë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Himarë për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Himarë për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Himarë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR**Edi Rama**

TABELA E SHPRONËSIMIT, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI PROJEKTTIT
“IMPIANTI I TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA HIMARË DHE LARGIMI I UJËRAVE TË TRAJTUARA NË DET PËR ITUN HIMARË”

NR.	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)						TRUALL			NDËRTESE			VLERA TOTALE (lek)	SHËNIME (kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)		
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Truall (m²)	Ndërtesë (m²)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek/m²)				Vlera (lek)
1	Feta Hysenaj			Himarë	1952	1/1799	Godinë	180	180	0	180	4,350	783,000			0	783,000	Depo pikë hapjeje 1763.	Konfirmuar nga ASHK-ja. Sipas raportit të vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe social të përgatitur nga eksperti i kontraktuar ka konkluduar se ndërtesa është 100% e amortizuar dhe vlerësimi bëhet vetëm për truall.
VLERA TOTALE																	783,000		

**VENDIM****Nr. 536, datë 13.9.2023****PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË
DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT
TË KUKËSIT**

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI :

1. Z. Albert Halilaj, prefekt i Qarkut të Kukësit, lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Granit Gjana emërohet prefekt i Qarkut të Kukësit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 537, datë 13.9.2023****PËR NJË SHITESË NË NUMRIN E
PUNONJËSVE ORGANIKË NË
ADMINISTRATËN E KUVENDIT PËR
VITIN 2023**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve të administratës së Kuvendit, për vitin 2023, shtohet me 16 (gjashtëmbëdhjetë) veta, duke e çuar numrin e përgjithshëm në 453 (katërqind e pesëdhjetë e tre) punonjës.

2. Numri rezervë i punonjësve për vitin 2023 reduktohet me 16 (gjashtëmbëdhjetë) veta, duke e

çuar numrin e përgjithshëm rezervë në 47 (dyzet e shtatë) punonjës.

3. Ngarkohen administrata e Kuvendit dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 538, datë 13.9.2023****PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË
ZBATIMIT PËR PROJEKTE TË
BASHKËPUNIMIT TEKNIK NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL,
DHE *DEUTSCHE GESELLSCHAFT FÜR
INTERNATIONALE
ZUSAMMENARBEIT (GIZ) GMBH***

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 22, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së zbatimit për projekte të bashkëpunimit teknik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dhe *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH*, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**Marrëveshje Zbatimi për Projekte të Bashkëpunimit Teknik****Përmbajtja****Baza e marrëveshjes****1. Objektivi i projektit****2. Kontributet e GIZ-it**

Vënia në dispozicion e ekspertëve

Furnizimi i materialeve dhe pajisjeve

Kostot operacionale dhe administrative

Kontribute të tjera

3. Kontributet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Vënia në dispozicion e ekspertëve dhe personelit ndihmës

Kostot

Vënia në dispozicion e zonave, ndërtesave dhe vendeve të punës

4. Dispozita të tjera

Vlerësimi

Pezullimi i kontributeve dhe ndërprerja e marrëveshjes

Afati i marrëveshjes

Përshtatja e marrëveshjes

Forma e shkruar

Marrëveshjet me organizatat individuale zbatuese

Zbatimi i marrëveshjes

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Hyrja në fuqi, kopjet



MARRËVESHJE ZBATIMI

ndërmjet

**Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë
të përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit
Rural**

Adresa :

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr.2, Tiranë

-në vijim e referuar si MBZHR-

dhe

**Deutsche Gesellschaft für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH**

Dag-Hammarskjöld-Weg 1-5

65760 Eschborn

-në vijim e referuar si "GIZ" -

në lidhje me projektin

Zhvillimi i Qëndrueshëm i Zonave Rurale në Shqipëri 2 (ZHQZR
2)

-në vijim i referuar si "Projekti" –

**Baza e marrëveshjes**

Sa më poshtë vijon do të përbëjë bazën e kësaj Marrëveshjeje:

- Marrëveshja për Bashkëpunimin Teknik, lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë, datë 21 tetor 1988, (shihni Shtojcën 1).
- Nota Verbale 294/2017 e datës 23 nëntor 2017 e Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë mbi alokimin e fondeve për projektin “Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale” (Shtojca 2).
- Procesverbali Përmbledhës i negociatave lidhur me Bashkëpunimin për Zhvillim ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë, datë 12 dhjetor 2017 (Shtojca 3).
- Procesverbali Përmbledhës i Negociatave për Bashkëpunimin Zhvillimor ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë më 22 nëntor 2018 (Shtojca 4).
- Nota Verbale 314/2018 e datës 30 nëntor 2018 e Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë që i referohet Procesverbalit Përmbledhës të Negociatave për Bashkëpunimin Zhvillimor ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë, datë 22 nëntor 2018 (Shtojca 5).
- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë lidhur me fondet e vitit 2017, për Projektin “Zhvillimi i Qëndrueshëm i Zonave Rurale”, datë 27 dhjetor 2018 (Shtojca 6).
- Ligji nr. 19/2019 për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për Projektin “Zhvillimi i Qëndrueshëm i Zonave Rurale në Shqipëri”, të miratuar nga Parlamenti i Shqipërisë, datë 21/03/2019 (shihni Shtojcën 7).
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.41, datë 22.01.2020 “Për marrëveshjen në parim të ndryshimit të Marrëveshjes, me shkëmbim të Notave Verbale, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë, për Bashkëpunimin Teknik 2017, për projektin “Zhvillimi i Qëndrueshëm i Zonave Rurale në Shqipëri”.
- Nota Verbale 146 / 2020 e datës 28 korrik 2020 e Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë për plotësimin e projektit ekzistues “Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale” (shihni Shtojcën 8) që i referohet Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Projektin “Zhvillimi i Qëndrueshëm i Zonave Rurale”, datë 27 dhjetor 2018 (shihni Shtojcën 6). Kjo Marrëveshje përcakton se përfshin çdo shtesë të mëtejshme fondesh nga Qeveria Gjermane.
- Procesverbali Përmbledhës i Negociatave për Bashkëpunimin Zhvillimor ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë, datë 24 nëntor 2020 (shihni Shtojcën 9).



- Nota Verbale 38 / 2021 e datës 17 shkurt 2021 e Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë për plotësimin e projektit ekzistues "Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale" (shihni Shtojcën 10) që i referohet Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Projektin "Zhvillimi i Qëndrueshëm i Zonave Rurale", datë 27 dhjetor 2018 (shihni Shtojcën 6). Kjo Marrëveshje përcakton se përfshin çdo shtesë të mëtejshme të fondeve nga Qeveria Gjermane.
- Nota Verbale 60 / 2021 e datës 26 mars 2021 e Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë për plotësimin e projektit ekzistues "Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale" (shihni Shtojcën 11) që i referohet Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Projektin "Zhvillimi i Qëndrueshëm i Zonave Rurale" datë 27 dhjetor 2018 (Shtojca 6) dhe duke iu referuar fondeve shtesë sipas shënimit verbal 38/2021 (shihni Shtojcën 10). Kjo Marrëveshje përcakton se përfshin çdo plotësim të mëtejshëm të fondeve nga Qeveria Gjermane.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.703, datë 18.11.2021 "Për miratimin, në parim, të marrëveshjes ndryshuese, me shkëmbim letrash, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin teknik 2017, për projektin "Zhvillim i Qëndrueshëm i Zonave Rurale", ratifikuar me ligjin nr.19/2019".
- Nota Verbale 181/2022 e datës 31.08. 2022 e Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë për plotësimin **dhe zgjerimin** e projektit ekzistues "Zhvillimi i Qëndrueshëm i Zonave Rurale" (shihni Shtojcën 12) që i referohet Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Projektin "Zhvillimi i Qëndrueshëm i Zonave Rurale" datë 27 dhjetor 2018 (shihni Shtojcën 6) dhe duke iu referuar fondeve shtesë sipas Notës Verbale 38 /2021 (Shihni Shtojcën 10). Kjo Marrëveshje përcakton se përfshin çdo shtesë të mëtejshme të fondeve nga Qeveria Gjermane.
- Procesverbali Përmbledhës i Negociatave për Bashkëpunimin Zhvillimor ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë, datë 13 dhjetor 2022 (Shtojca 13).



- 1. Objektivi i projektit

Objektivi i këtij Projekti është të arrijë një transformim ekonomik të zonave rurale në Shqipëri, i cili është i vlefshëm për popullsinë vendase, duke përfshirë të kthyerit nga emigracioni. Plani i përditësuar i operacioneve do të përcaktohet dhe bihet dakord ndërmjet palëve pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe do të miratohet çdo vit në mbledhjen e Komitetit Drejtues.

GIZ dhe MBZHR janë të angazhuar bashkërisht për këtë objektiv. Objektivi matet nga treguesit e mëposhtëm (rezultatet):

1. 5,105 persona, duke përfshirë 1,170 gra, 1,635 të rinj dhe 370 të kthyer kanë përmirësuar situatën e tyre të punësimit.
2. 3600 Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme, 900 prej të cilave drejtohen nga të rinjtë dhe 360 nga të kthyerit nga emigrimi, kanë treguar se MSME-të kanë investuar në konkurrencën e tyre.
3. Nga ministritë përkatëse janë miratuar 10 rekomandime të politikave kombëtare të bazuara në fakte për transformimin e tregut të zonave rurale ose për afrimin me BE-në.

Fushat e ndërhyrjes ("Rezultatet") përfshijnë:

1) Produkti 1 synon të provojë aftësinë e inovacioneve të përzgjedhura për t'u zbatuar në sektorin agro-ushqimor si dhe në turizmin rural. Supozimi është se NVM-të (përfshirë fermerët e vegjël) mund të aplikojnë inovacione të realizueshme, duke rritur kështu konkurrencën e tyre, duke hapur tregje fitimprurëse dhe duke e vendosur transformimin ekonomik me vlerë për popullsinë vendase.

2) Produkti 2 synon të shkallëzojë inovacionet ekonomikisht të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme mjedisore. Bashkëpunimi ndërmjet aktorëve privatë dhe publikë në rrjetet e inovacionit (partneritete me shumë palë të interesuara) mund të motivojë një numër të konsiderueshëm NVM-sh për të investuar në inovacion (shkallëzim) për të kontribuar në krijimin e të ardhurave dhe vendeve të punës.

3) Produkti 3 synon të garantojë që modelet e vendimeve strategjike për krijimin e klimës së biznesit në zonat rurale, janë të bazuara në prova. Vendimet strategjike të politikave duhet të krijojnë një klimë të favorshme biznesi, e cila duhet të bazohet në të dhëna të besueshme dhe ligjërime të informuar (dialog publik-privat) në mënyrë që të promovojë zhvillimin e NVM-ve dhe krijimin e të ardhurave dhe vendeve të punës.

4) Produkti 4 synon të mbështesë bizneset për të zbutur efektet ekonomike të Pandemisë Covid-19: me një strukturë këshillimore të referuar si "CoSolve-19" NMVM-të në bujqësi, turizëm dhe sektorë të tjerë mbështeten me një kombinim shërbimesh këshillimore dhe këshillimi për nivelin e shoqërive dhe grantet. CoSolve-19 zbatohet së bashku me projektin ProSEED të financuar nga BMZ-ja. Grantet do të menaxhohen nga SRD-ja ndërsa shumica e kontratave të ekspertëve për shërbimet këshillimore menaxhohen nga ProSEED. Një strukturë e përbashkët drejtuese me ministritë partnere të dy projekteve do të sigurojë zbatimin e qëndrueshëm të CoSolve-19.

Një ndryshim i objektivit ose fushave të ndërhyrjes është gjithmonë objekt i miratimit nga Qeveria Gjermane.



Kohëzgjatja totale e Projektit, duke marrë parasysh ndryshimin e buxhetit në dispozicion ,do të jetë 3 vjet (2023-2025).

Treguesit për totalin e projektit janë përcaktuar në komisionin e BMZ-së. Çdo ndryshim, teknik apo financiar do të zyrtarizohet nëpërmjet një marrëveshjeje ndërmjet Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Projekti do të zbatohet së bashku me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) si dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) si partnerët kryesorë të Projektit. Në varësi të aktiviteteve në përputhje me objektivin e Projektit, SRD-ja mund të përfshijë agjenci të tjera si partnerë të drejtpërdrejtë të Projektit.

GIZ dhe MBZHR do të krijojnë dhe mbajnë strukturën drejtuese dhe zbatuese të mëposhtme për kohëzgjatjen e Projektit:

Emri	Përfaqësimi	Roli	Shpeshtësia
Komiteti Drejtues	Ministër ose Zëvendës Ministër MBZHR dhe MTM, Pikat Fokale të MBZHR-së dhe MTM-së, menaxher i programit të GIZ-it, menaxherë të komponentëve të GIZ-it. Përfaqësues nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC)	Udhëzimi strategjik, miratimi i planit vjetor të operacioneve, monitorimi i performancës	Vjetore (T1), sipas kërkesës
Ekipi Koordinues	Pikat Fokale në MBZHR / MTM, programet e GIZ-it dhe menaxherët e komponentëve	Koordinimi i përgjithshëm i programit	Në vazhdim
Grupet Teknike të Punës	Kabineti dhe stafi teknik dhe Pika Fokale e MBZHR-së/MTM-së, Ekipi i GIZ-it	Planifikimi i detajuar, teknik dhe zbatimi i paketave të aktiviteteve sipas planit operacional	Në vazhdim

Komiteti Drejtues:

- Do të krijohet me fillimin e projektit të ndryshuar me funksione, detyra dhe anëtarësi të qarta;
- Merr vendime për çështjet strategjike të Projektit dhe miraton planin vjetor të zbatimit;
- Monitoron performancën e Projektit;
- Mblidhet në tremujorin e parë të çdo viti dhe sa herë është e nevojshme.



Për lehtësimin e CoSolve-19, një Strukturë Drejtuese e veçantë është përcaktuar së bashku me ministritë përkatëse partnere dhe duke përfshirë të dy projektet e GIZ-it (SRD dhe ProSEED).

Komunikimi dhe raportimi:

Të dyja palët synojnë të mbajnë njëra-tjetrën të përditësuar me zhvillimet më të fundit të aktiviteteve të programit, sektorët, ministritë, qeveria në përgjithësi, agjencitë shtetërore, donatorët dhe zbatuesit

Raportet përfundimtare të ekspertëve shpërndahen vazhdimisht në Grupet Teknike të Punës.

2. Kontributet në Projekt nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë nëpërmjet GIZ-it

Në përputhje me Notën Verbale 181/2022 të datës 31.08.2022, Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë do t'i sigurojë GIZ-it deri në 7,5 milionë Euro (me fjalë, shtatë milionë e pesëqind mijë Euro) për kontributin gjerman midis periudhës 2023 dhe 2025. Kjo shumë do të përfshijë kostot e shkaktuara nga Organizata Zbatuese Gjermane.

2.1 Vënia në dispozicion e ekspertëve

GIZ do të vërë në dispozicion për Projektin:

- një ekspert të kontraktuar si menaxher programi që do të jetë përgjegjës për kontributin e GIZ-it dhe i cili në të njëjtën kohë do të jetë drejtues i ekipit të ekspertëve të vënë në dispozicion për këtë Projekt për kohëzgjatjen e Projektit të përshkruar në Klauzolën 4 më poshtë,

- *ekspertët e mëposhtëm:*

- një ekspert i kontraktuar për bujqësinë për kohëzgjatjen e Projektit;
- një ekspert kombëtar për turizmin rural për kohëzgjatjen e Projektit;
- deri në tetë ekspertë kombëtarë për bujqësinë dhe turizmin rural për kohëzgjatjen e Projektit;
- nënkontraktimi i ekspertëve ndërkombëtarë dhe kombëtarë sipas nevojave;

Periudha e dërgimit të ekspertëve të kontraktuar do të përfshijë edhe lejen vjetore në përputhje me dispozitat e ligjit gjerman.

2.2 Furnizimi me materiale dhe pajisje

GIZ do të furnizojë artikujt e mëposhtëm për pajisjen me infrastrukturë teknike:

- orendi, pajisje teknike dhe materiale të tjera të nevojshme brenda objektit dhe gjatë afatit të zbatimit të Projektit;

2.3 Kostot operative dhe administrative

GIZ do të mbulojë kostot operative dhe/ ose administrative që lidhen me procesin e kontributit gjerman në projekt.



2.4 Kontribute të tjera

GIZ mund të japë kontribut financiar për një organizatë. Detajet e këtij kontributi financiar do të përcaktohen në një marrëveshje financimi ndërmjet GIZ-it dhe marrësit të kontributit financiar.

GIZ mund të ofrojë subvencione lokale për një organizatë lokale dhe NVM-të. Detajet e këtyre subvencioneve vendore do të përcaktohen në një marrëveshje ndërmjet GIZ-it dhe përfituesit të subvencionit vendor.

3. Kontributet nga MBZHR-ja

3.1 Vënia në dispozicion e ekspertëve dhe personelit ndihmës

MBZHR-ja do të vërë në dispozicion kontributet e mëposhtme shtesë:

- të garantojë përfaqësimin e duhur të organizatës së tyre në strukturat drejtuese dhe zbatuese të Projektit;
- të sigurojë një pikë të kualifikuar kontakti për të drejtuar projektin e përgjithshëm në palën shqiptare;
- të ofrojë ekspertë të brendshëm teknikë nga Drejtoritë përkatëse të MBZHR-së në përputhje me nevojat e Projektit për të marrë pjesë dhe konceptuar aktivitetet e projektit;

3.2 Kostot

Referuar ndryshimeve të pritshme në ligjin nr. 92/2014 “ Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ku parashikohet që për projektet e financuara me fonde të marra në bazë të një marrëveshje donacioni/granti, të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve të huaj, të përjashtohen nga aplikimi i TVSH-së.

MBZHR do të:

- përballojë të gjithë TVSH-në për aktivitetet e projektit dhe shpenzimet e lidhura me to, të kryera në Shqipëri (kostot rrjedhëse dhe prokurimet), si dhe për prokurimet/importet ndërkombëtare dhe të sigurojë buxhetim të mjaftueshëm në kohën e duhur.
- rimbursojë TVSH-në e vlefshme për të gjithë periudhën e zbatimit të projektit, në datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë (shtojca 5).

Shuma totale e TVSH-së e parashikuar për rimbursim për implementimin e 7.5 milionë Euro është afërsisht 1.5 milion Euro.

Për rimbursimin e TVSH-së, GIZ duhet të dorëzojë dokumentet që vërtetojnë furnizimin e mallrave, shërbimeve ose importeve që i përkasin periudhës nga data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë gjatë kohëzgjatjes së projektit.



Raportet financiare duhet të dërgohen në mënyrë elektronike në pikën fokale për rimbursimet e TVSH-së dhe monitorimin e brendshëm të buxhetit të MBZHR-së në përputhje me autorizimin e GIZ-it nga BMZ-ja:

- buxheti total i shpenzimeve për vitin e ardhshëm, duke përfshirë pjesën e TVSH-së (vjetore, në janar) dhe për produktet e vitit të kaluar (vjetor, në mars).
- Kërkesa për rimbursim të TVSH-së në intervale të rregullta, duke përfshirë listën e detajuar të faturave dhe aktivitetet treguese, dhe të ndara sipas përgjegjësisë ministrore (MARD ose MT). Rimbursimi i TVSH-së nga MBZHR-ja për shpenzimet e shkaktuara në kuadër të aktiviteteve të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, do të kryhet duke marrë në konsideratë konfirmimin e institucionit përkatës mbi furnizimin e mallrave apo shërbimeve të dorëzuara.

3.3 Vënia në dispozicion e zonave, ndërtesave dhe ambienteve të punës

MBZHR-ja do të vendosë në dispozicion të Projektit pa pagesë vendet dhe ndërtesat e mëposhtme, duke përfshirë pajisjet dhe orenditë, në masën që këto pajisje dhe orendi nuk ofrohen nga GIZ-i:

- një ambient zyre në ambientet e MBZHR-së që do të përdoret nga ekspertët e Projektit GIZ, duke përfshirë edhe pastrimin.
- atriumi i godinës së MBZHR-së për evente të përbashkëta.

4. Dispozita të tjera

4.1 Vlerësimi

GIZ-i mund të kryejë një vlerësim të projektit gjatë ose pas zbatimit të kësaj marrëveshjeje. Për këtë, GIZ-i do të caktojë ekspertë të emëruar nga shteti/vlerësues të projektit. MBZHR-ja dhe MTM-ja do të bashkëpunojnë gjatë këtij vlerësimi. MBZHR-ja do të ndihmojë në çdo rast ekspertin(-ët)/vlerësuesin(-sit) dhe do t'i lejojë ata të shqyrtojnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

MBZHR-ja do të informohet lidhur me rezultatet e këtij vlerësimi me anë të një raporti.

4.2 Pezullimi i kontributeve dhe ndërprerja e Marrëveshjes

GIZ-i mund të pezullojë kontributet e tij, në rast se:

- MBZHR-ja nuk do të plotësojë detyrimet e saj që rrjedhin nga kjo Marrëveshje ose nga masat lidhur me këtë marrëveshje, ose
- rrethanat janë të tilla që përjashtojnë ose vënë në rrezik të konsiderueshëm objektivin e projektit, siç përshkruhet në Klauzolën 1 më sipër.

Nëse një nga rrethanat e përshkruara në fjalinë 1 më sipër, lind dhe ekziston ende pas një afati kohor për t'u rënë dakord nga GIZ me MBZHR-në ose nëse nuk eliminohet brenda kësaj periudhe, GIZ, me pëlqimin e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, mund të ndërpresë para kohe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.



4.3 Afati i Marrëveshjes

Përveç siç parashikohet në Klausolën 4 më sipër për pezullimin e kontributeve dhe përfundimin e Marrëveshjes, kjo Marrëveshje do të jetë e vlefshme për kohëzgjatjen e fazës në vazhdim të Projektit (aktualisht e planifikuar të zgjasë nga 1 janari 2023 deri më 31 dhjetor 2025). Ajo do të jetë e vlefshme për 6 muaj të tjerë pas përfundimit të projektit për qëllime të raportimit financiar. Afati i kësaj Marrëveshjeje mund të zgjatet në rast të një vonese në ekzekutimin e kontributit gjerman, siç përcaktohet në këtë Marrëveshje dhe në ekzekutimin e kontributeve të rëna dakord të MBZHR-së.

4.4 Përshtatja e marrëveshjes

Në rast se dispozitat e kësaj marrëveshjeje nuk arrijnë të plotësojnë zbatimin efikas të objektivit të përcaktuar në Klausolën 1 më sipër, atëherë GIZ-i dhe MBZHR-ja mund të përshtatin ose të ndryshojnë këto dispozita me pëlqimin e të dyja palëve në çdo fazë gjatë zbatimit të projektit. Çdo ndryshim do të bëhet me shkrim.

GIZ-i mund ta ndërpresë këtë Marrëveshje në mënyrë të njëanshme, nëse autorizimi që i është dhënë nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, tërhiqet.

4.5 Forma e shkruar

Ndryshimet dhe shtesat e kësaj marrëveshjeje dhe çdo deklaratë tjetër e rëndësishme dhe komunikim i rëndësishëm për ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje, do të bëhet me shkrim. Në rastin e deklaratave dhe komunikimeve për GIZ-in, do të jetë e mjaftueshme që të merren nga drejtuesi i ekipit të ekspertëve të caktuar.

4.6 Marrëveshjet me organizatat individuale zbatuese

Personi përgjegjës për kontributet nga ana e GIZ-it dhe personi(-at) përgjegjës për kontributet nga organizata partnere apo organizatat e tjera zbatuese mund të lidhin së bashku një marrëveshje detyruese mbi detaje shtesë që lidhen me ekzekutimin e projektit (p.sh. mbi bazën e planit operacional) ose që në një mënyrë tjetër të përshtatshme të përcaktojnë këto detaje me shkrim dhe kur është e nevojshme, të përshtatin çdo marrëveshje të tillë që të marrë parasysht zhvillimet e projektit.

4.8 Zbatimi i Marrëveshjes

Lidhur me dispozitat që nuk janë mbuluar nga kjo Marrëveshje, do t'i referohet dispozitave të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë për Bashkëpunimin Teknik, (shihni Shtojcën 1), dhe Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë mbi angazhimet e lidhura me Bashkëpunimin Teknik, (shihni Shtojcën 4 dhe Shtojcën 5), të dyja referuar në fillim të kësaj Marrëveshjeje.

4.8 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast se lindin mosmarrëveshje ndërmjet palëve, sugjerohet që ato të zgjidhen me anë të negociatave. Në rast se kjo rezulton pa sukses, do të ndiqet komunikimi përmes rrugëve diplomatike.



4.10 Hyrja në fuqi, kopjet

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e njoftimit të palës shqiptare për përfundimin e procedurave të brendshme ligjore. Ajo do të hartohet në katër kopje origjinale: dy kopje në gjuhën angleze dhe dy kopje në gjuhën shqipe. Në rast mosmarrëveshjeje lidhur me interpretimin e tekstit, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Tiranë, *Maj* 2023

Tiranë, *Maj* 2023

Erinda Krifca
Ministre e Bujqësisë & Zhvillimit Rural

Dr. Sonja Kurz
Drejtoresh e GIZ-it në Shqipëri



VENDIM

Nr. 539, datë 13.9.2023

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 456, DATË 22.5.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRBËRJEN DHE MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË KOMITETIT KOMBËTAR TË SHËNDETIT MENDOR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 30, të ligjit nr. 44/2012, “Për shëndetin mendor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 456, datë 22.5.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Ngritjen e Komitetit Kombëtar të Shëndetit Mendor (në vijim “KKSHM”), organ këshillimor i ministrit përgjegjës për shëndetësinë, i cili të kryesohet nga zëvendësministri përgjegjës për shëndetësinë dhe ka në përbërje këta anëtarë:

a) drejtuesin e njësisë që mbulon çështje të shëndetit publik e të kujdesit shëndetësor parësor në ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë;

b) drejtuesin e njësisë që mbulon çështje të planifikimit spitalor në ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë;

c) drejtuesin e njësisë që mbulon çështje të planifikimit financiar në ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë;

ç) drejtuesin e njësisë që mbulon çështjet juridike në ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë;

d) drejtuesin e njësisë që mbulon çështjet e shërbimeve sociale në ministrinë përgjegjëse për mbrojtjen sociale;

dh) përfaqësuesin e ministrisë përgjegjëse për çështjet e drejtësisë;

e) përfaqësuesin e ministrisë përgjegjëse për çështjet e arsimit;

ë) përfaqësuesin e ministrit përgjegjës për fëmijët dhe rininë;

f) shefin e Shërbimit të Psikiatrisë në QSUT;

g) drejtuesin e Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore;

gj) përfaqësuesin e Qendrës Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët;

h) përfaqësuesin e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor;

i) përfaqësuesin e Institutit të Shëndetit Publik;

j) përfaqësuesin e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;

k) përfaqësuesin e Shërbimit Social Shtetëror;

l) përfaqësuesin e Agjencisë së Sigurimit të



Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror;

ll) përfaqësuesin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, që mbulon çështjet e personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore;

m) përfaqësuesin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi;

n) përfaqësuesin e Avokatit të Popullit;

nj) përfaqësuesin e Policisë së Shtetit;

o) përfaqësuesin e shërbimeve komunitare të shëndetit mendor, i caktuar nga ministri përgjegjës për shëndetësinë;

p) përfaqësuesin e spitaleve psikiatrike, i caktuar nga ministri përgjegjës për shëndetësinë;

q) përfaqësuesin e Shoqatës së Bashkive.”.

2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Në mbledhjet e KKSJM-së ftohen të marrin pjesë përfaqësues nga përdoruesit/familjarët e përdoruesve të shërbimeve të shëndetit mendor dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, që promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e personave me çrregullime të shëndetit mendor, si dhe përfaqësues nga organizma të ndryshëm ndërkombëtarë, që kanë zyrat e përfaqësimit në Shqipëri dhe kanë në fushën e veprimtarisë së tyre çështje të shëndetit mendor.”.

3. Në nënndarjen e parë, të pikës 3, pas fjalëve “-përfaqëson KKSJM-në ...” shtohen “... dhe siguron një mjedis mbështetës në KKSJM, bashkërendimin ndërdisiplinar, ndërsektorial dhe ndërinstitutional, shkëmbimin e informacionit, të dijeve dhe përvojës, duke mundësuar ndërveprimin e bashkëpunimin ndërmjet aktorëve brenda dhe jashtë vendit, në fushën e shëndetit mendor ...”.

4. Në pikën 4, fjalët “Sektori i shëndetit mendor dhe adiktologjisë në Ministrinë e Shëndetësisë ...” zëvendësohen me “Sektori që mbulon çështje të shëndetit mendor në ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë ...”.

5. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Komiteti Kombëtar i Shëndetit Mendor këshillon ministrin përgjegjës për shëndetësinë për:

a) zhvillimin e politikave për ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit mendor të fëmijëve, adoleshentëve, të rinjve, të rriturve, të moshuarve në Shqipëri;

b) deinstitutionalizimin e orientimin komunitar të shërbimeve të shëndetit;

c) ofrimin e bashkërenduar të shërbimeve shëndetësore dhe sociale, parandaluese, trajtuese, rehabilituese dhe riintegruese;

ç) mundësimin e një zinxhiri shërbimesh për shëndetin mendor, që të jenë cilësore, të disponueshme, të pranueshme dhe të arritshme për të gjithë;

d) mbrojtjen e të drejtave të personave me çrregullime të shëndetit mendor përgjatë gjithë harkut të jetës, në komunitet, në institucione të kujdesit shëndetësor e social, me shtretër dhe pa shtretër, si dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe në institucionet e posaçme mjekësore;

dh) rajonizimin e rrjeteve të plota të shërbimeve të shëndetit mendor, në harmoni me planet e strukturimit dhe racionalizimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor e spitalor;

e) ndërmarrjen e nismave ligjore e nënligjore për shëndetin mendor dhe zbatimin e legjislacionit përkatës;

ë) monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të politikave të shëndetit mendor.

6. Pas pikës 7 shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:

“7/1. Komiteti ngre nënkomitetin për shqyrtimin e çështjeve të lidhura me shëndetin mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve, i cili përbëhet nga ekspertë të fushës, që mbulojnë çështje të ndryshme lidhur me mirëqenien e shëndetit mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve. Nënkomiteti asiston komitetin për analizë dhe vlerësim të situatës së shëndetit mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve e shërbimeve sociale dhe shëndetësore përkatëse. Nënkomiteti i propozon komitetit ndërhyrje strategjike apo programatike, si dhe ndryshime rregullatore, të cilat synojnë përmirësimin e shëndetit mendor për fëmijët dhe adoleshentët.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**KËRKESË****Nr. 324/6, datë 12.9.2023****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Rikonstruksioni i shesheve të pallateve në lagjen ‘Partizani’, ZK 8524, Bashkia Elbasan”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Elbasan.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, për pasuritë e llojit “truall” dhe “arë” bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, ndërsa vlerësimi ndërtesës është llogaritur bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.2.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të

përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik, për pasuritë e llojit “ndërtesë banimi ose jo banimi”, i ndryshuar.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Elbasan, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 2 950 743.4 (dy milionë e nëntëqind e pesëdhjetë mijë e shtatëqind e dyzet e tre pike katër) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Egra Ibrahim



LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “RIKONSTRUKSIONI I SHESHEVE TË PALLATEVE NË LAGJEN ‘PARTIZANI’, ZK. 8524, BASHKIA ELBASAN”

NR.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKARE										VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM												SHËNIME (D+E) (kuqizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)
														ARË			"TRUALL"			"NDËRTESE"			Vlera e kulturës bujqësore dhe drufrutoreve sipas procesverbalit të Drejtorisë së Bujqësisë			
	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Arë (m²)	Truall (m²)	Ndërtesë (m²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Cmimi (lek/m²)	Vlera(lek)	Sipërfaqja (m²)	Cmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	Sipërfaqja (m²)	Cmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	Vlera e kulturës bujqësore (lek)	Vlera e dru- frutoreve (lek)		
	A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	S	T	U	V	Y	Z		
1	PERUSJAN AGIM SHELEGU			ELBASAN	8524	2/803	TRUALL	24	0	24	0	21	54	0	0	0	24	13,854.00	332,496.00	-	-	-	-	-	332,496.00	D- Mbi këtë truall ndodhet ndërtesa me nr. 2/789-ND, vol. 20, f. 185.
2	PERUSJAN AGIM ZHELEGU			ELBASAN	8524	2/789-ND	NDËRTESE	24	0	0	24	20	185	0	0	0	0	-	-	24.00	-	394,121.00	-	-	394,121.00	D- Kjo ndërtesë ndodhet mbi truallin 2/803, vol. 21, f. 54.
3	DALLANDYSHE DEMIR CAKA			ELBASAN	8524	2/886	TRUALL	40.6	0	40.6	0	27	225	0	0	0	40.6	13,854.00	562,472.40	-	-	-	-	-	562,472.40	D- Mbi këtë truall ndodhet ndërtesa me nr. pas. 2/886-ND
4	DALLANDYSHE DEMIR CAKA			ELBASAN	8524	2/886-ND	NDËRTESE	40.6	0	0	40.6	27	226	0	0	0	0	-	-	40.60	-	960,899.00	-	-	960,899.00	D- Kjo ndërtesë ndodhet mbi truallin nr. pas. 2/886, vol. 27, f. 225. E- kufizohen veprimet deri në krijimin e miratimin e VKM-së për parcelën ndërtimore.
	DALLANDYSHE DEMIR CAKA			ELBASAN	8524	2/18	TRUALL	24	0	24	0	30	75	0	0	0	24	13,854.00	332,496.00	-	-	-	-	-	332,496.00	D- Kjo ndërtesë ndodhet mbi truallin 2/18-ND, vol. 1, f. 62.
	DALLANDYSHE DEMIR CAKA			ELBASAN	8524	2/18-ND	NDËRTESE	24	0	0	24	1	62	0	0	0	0	-	-	24.00	-	368,259.00	-	-	368,259.00	D- Kjo ndërtesë ndodhet mbi truallin 2/18, vol. 1, f. 62.
5				ELBASAN	8524	2/804	TRUALL	9.4	0	0	0	21	55	0	0	0	9.4	-	-	-	-	-	-	-	E- Mbi këtë pasuri ka një ndërtim të pa ligjshëm pjesërisht.	
6	SHTET			ELBASAN	8524	2/1192	TRUALL	6.7	0	0	0	0	0	0	0	0	6.7	-	-	-	-	-	-	-	-	Nuk ka
	SHUMA																								2950743.40	

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë